

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

E nderuar kryesuese e seancës,

Do të ishte vërtet shumë e lehtë që, duke votuar nenin x/ y, të hiqim një barrë të rëndë historike, e cila kthehet dhe rikthehet si fantazmë dhe pushton ndërgjegje individësh, por edhe grupesh shoqërore. Në qoftë se sot na ndjek pjesa dinamike e shoqërisë, 20-vjeçarët, 30-vjeçarët, apo edhe 40-vjeçarët, normalisht, mund të na drejtonin pyetjen: *what are you talking about?*

Duhet t'u kishim dhënë zgjidhje këtyre problemeve shumë vite më parë, edhe pse nuk është e lehtë, edhe pse nuk është e thjeshtë, madje është tepër e komplikuar. Edhe në vende të tjera ka pasur një ecuri të tillë, plot ecejake, ku janë implikuar edhe liderët më të lartë politikë, si në Çeki, Vaclav Havel dhe kështu me radhë. Janë dhënë zgjidhje të ndryshme dhe janë aplikuar praktika të ndryshme. Mund të kishim përfituar edhe ne dhe të mos e kishim lënë këtë çështje, siç e kemi lënë deri më sot.

Kur hyra për herë të parë në parlament, 26 vjet më parë, zhvillohej një debat i ngjashëm. Ishte votuar një ligj, i cili përjashtonte nga kandidimi nëpunës të lartë dhe udhëheqës institucionesh në periudhën e komunizmit dhe, faktikisht, nga një palë zgjedhje u përjashtuan disa individë të tillë, por, sapo erdhi partia tjetër në pushtet, i abrogoi këto sanksionime dhe jo vetëm që i riktheu individët, por riktheu edhe frymën.

Zotërinj,

Nuk është çështje e një neni apo e një ligji, është çështja e së vërtetës, është çështja e katarsisit, që në vendin tonë nuk ka ndodhur dhe me sa shoh dhe vlerësoj, nuk mund të ndodhë as me aktet e sotme. Në poetikën e vet Aristoteli thoshte: "Efekti i një tragjedie që ndjekin njerëzit është të purifikojë botën e tyre emocionale". Ne nuk pamë një tragjedi thjesht si një zhanër dramatik, ne jetuam një tragjedi, një tragjedi dekadash, dhe cektësia me të cilën po e trajtojmë edhe sot, nuk i jep asnjë garanci atij që ka vuajtur personalisht burgun, internimin dhe aq më shumë pushkatimin; nuk u jep asnjë garanci familjarëve të tyre, të cilët patën një jetë të syrgjynosur për arsye ideologjike, etnike, fetare dhe ne mendojmë se me një retushim neni mund të rehabilitojmë ndërgjegje individuale dhe kolektive. Jo, zotërinj, kërkohet e vërteta!

Pas Luftës së Dytë Botërore, në atë histori tragjike dhe me krimet që shkaktoi Japonia, si pjesë e boshtit të së keqes, në vitin 1948 u inaugurua një bibliotekë e madhe në parlamentin japonez dhe në hyrje të saj është shkruar në gjuhën greke dhe japoneze një thënie biblike: "E vërteta çliron". Ne nuk jemi të çliruar, shoqëria jonë nuk është e çliruar nga e shkuara e komunizmit, e ish-Sigurimit, e mentalitetit dhe e praktikave, ndaj edhe sot që diskutojmë duhet të jemi realistë me veten, me njëri-tjetrin.

Çfarë ka ndodhur gjatë këtyre viteve? A i jemi distancuar ne fenomenit dhe mentalitetit shoqëruar? A jemi distancuar ne, përpara se të vijmë te viktimat, te xhelatët? Jo! Ne kemi parë titullarë të organeve të persekutimit të jenë ulur këmbëkryq në sallën e Kuvendit, të kenë drejtuar institucione të rëndësishme për vite me radhë dhe sot, me një hipokrizi ekstreme, me një frymë mesquine, u rikthehemi momenteve

më tragjike të historisë të kësaj treve, të këtij vendi, të këtij populli, pas Luftës së Dytë Botërore. Jo, zotërinj, ne nuk jemi distancuar, dhe kryesisht, më ndjeni, zotërinj të maxhorancës, ju në radhë të parë, si vazhdues të Partisë Komuniste dhe të Partisë së Punës, nuk keni kërkuar një ndjesë të sinqertë publike, një distancim publik nga e shkuara e partisë suaj. Ju vetë duhet të ishit në vijën e parë të kësaj fryme të re. Pse nuk ndodh kjo? Sepse, edhe sot, ju dhe kreu juaj përdorni praktika që përdorëshin gjatë kohës së ish-Sigurimit të Shtetit. Shikoni si etiketon! Shikoni si stigmatizon! Shikoni si fokusohet në individë, thjesht dhe vetëm se nuk u shkojnë pas politikave të tij! Ju nuk mund të jeni të sinqertë, ju nuk mund të jeni të besueshëm, që nga momenti kur nuk ngrini zërin ndaj këtyre fenomeneve. Ju nuk guxoni të përmendni emrat e ish-kolegëve tuaj, të cilët i ngritët në postet më të larta, kur ka qenë botërisht e njohur se ç'funsione kanë pasur gjatë regjimit komunist. Kështu do të vijë katarsisi? Kështu do të mbizotërojë e vërteta? Kështu do të bëhet purifikimi i shoqërisë sonë? Jo, zotërinj! Mua, të paktën, më lejoni ta them hapur, më krijoni idenë se në vend të purifikimit ju kërkoni instrumentalizimin, ju kërkoni që edhe sot, pas 32 vjetësh, të instrumentalizoni, të shantazhoni dhe jo të sillni atë që presin të gjithë, që është me të vërtetë e kërkuara e këtij ekuacioni, pra e vërteta, e cila është çliruese, sepse çliron ndërgjegje, mentalitete, energji, ndihmon në kompaktësimin shoqëror dhe në arritjen e objektivave madhorë.